



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER



Nr. 2015/1 Prot
07.05.2025



Nr.319/1 prot.

Shkodër, më 05.05.2025

Lënda: Mbi Vendimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës Nr.29, datë 28.04.2025.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti përcaktuar në dispozitat e ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8 germa a, neni 16, Urdhërit të Kryeministrit Nr.21, datë 5.02.2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 54/n, neni 55/2, neni 64 germa c, shqyrtoi Vendimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës Nr.29, datë 28.04.2025 “Për miratim sistem pikëzmi për dy programe të strehimit social për 2025”.

Pas trajtimit, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm ligjor, duke respektuar shpalljen publikisht të kriterëve sipas nenit 15, pika 1/1 e ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social” i përditësuar në respekt të parimit të gjithëpërfshirjes dhe mosdiskriminimit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 29 datë 28.04 2025

“PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL”

Në mbështetje të nenit 24, neni 54 gërma “n” e Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr 22/2018 “ Për strehimin social” i ndryshuar , neni 15 dhe neni 16, VKM nr 384, datë 12.06.2019 “ Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore,VKM 362,datë 29.05.2019 për kriteret e dhenies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gezojnë përparsi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë,nëpermjet buxhetit të shtetit dhe menyren e llogaritjes së tij: Të hartuar nga Komisioni i Strehimit i ngritur me VKB nr.21 datë 26.03.2025:Këshilli Bashkiak:

VENDOSI

1. Miratimin e sistemit të pikëzimit, i cili do përdoret për përzgjedhjen e subjekteve apo familjeve përfituese të programit të **“Subvencioni i qiras, në tregun e lirë”**.
2. Miratimin e sistemit të pikëzimit, i cili do përdoret për përzgjedhjen e subjekteve apo familjeve përfituese të programit **“Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme”**.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Zv/Kryetar Këshilli

Frano Prenga

Sekretar Këshilli

Ardian Celepija

Miratuar me 22 vota

Vota Pro 22

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me Datë 02.05 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E MBROJTJES, PËRFISHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL
SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL

Nr. 1768 prot.

Vau Dejës, me 17 / 09 / 2025

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim

Z. Ervis Shimaj

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK – VAU DEJËS

I nderuar zoti Kryetar!

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projektvendimin dhe materialin shoqërues për:

1-“Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e strehimit “ **Subvencioni i qiras, në tregun e lirë**”

2- Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e strehimit “**Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme**”

të hartuar nga Komisioni i Strehimit i ngritur me VKB nr.21 datë 26.03.2025”

Me respekt

KRYETARI
Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI
Aleksandra Gjoni

Konceptoi: E.Gjecaj

Pranoi: D.Lleshi

Miratoi: R.Luzaku

Konfirmoi Bazen Ligjore: E.Preka

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: _____

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: _____

Nr. i ifletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E MBROJTJES, PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL
SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL

PROJEKT-VENDIM

Nr. 8 datë 17.04 2025

PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMET E STREHIMIT
SOCIAL

Në mbështetje të nenit 24, neni 54 gërma "n" e Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligji nr 22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, neni 15 dhe neni 16, VKM nr 384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore, VKM 362, datë 29.05.2019 për kriteret e dhenies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gezojnë përparsi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet bugjetit të shtetit dhe menyren e llogaritjes së tij: Të hartuar nga Komisioni i Strehimit i ngritur me VKB nr.21 datë 26.03.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e sistemit të pikëzimit, i cili do përdoret për përzgjedhjen e subjekteve apo familjeve përfutuese të programit të "Subvencioni i qiras, në tregun e lirë", bashkëlidhur.
2. Miratimin e sistemit të pikëzimit, i cili do përdoret për përzgjedhjen e subjekteve apo familjeve përfutuese të programit "Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme", bashkëlidhur.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

KRYETAR
Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI

Aleksandra Gjoni



Konceptoi: E.Gjecaj

Pranoi: D.Lleshi

Miratoi: R.Luzaku

Konfirmoi Bazen Ligjore: E.Preka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E MBROJTJES, PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL
SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL

Vau Dejës, me ____ / ____ / 2025

**“PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMET E
STREHIMIT SOCIAL”**

RELACION

Bazuar në nenin 15 të Ligjit 22/2018 për “Strehimin Social” i ndryshuar, përzgjedhja e individëve e familjeve përfituese realizohet përmes sistemit të pikëzimit i cili miratohet me vendim të këshillit bashkiak, për programet e strehimit social që zbatohet në njësinë e vetqeverisjes vendore bazuar në kriteret e përcaktuar në ligj.

Me qëllim zbatimin e programeve të strehimit në Bashkinë Vau Dejës paraqesim për miratim projekt-vendim “Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programet të strehimit social” si më poshtë:

- Sistemi i pikëzimit sipas programit të Strehimit Social “Subvencioni i qirasë, në tregun e lire”
- Sistemi i pikëzimit sipas programit të Strehimit Social “Përmirësimi i kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme”

Duke qënë se sistemi i pikëzimit përbën instrumentin kryesor të përzgjedhjes së familjeve aplikuse propozojmë miratimin e sistemeve të pikëzimit në zbatim të programeve të strehimit social.

Konceptoi: E.Gjeçaj 



BASHKIA VAU DEJËS
Komisioni i Strehimit

Nr 1716 Prot

Vau Dejës, me 15 / 04 / 2025

PROCESVERBAL

Sot me datë 14.04.2025 ora 10:00 në Bashkinë Vau Dejës u mbajt mbledhja e Komisionit të Strehimit.

Në nenin 15 të ligjit Nr. 22/2018 për “ Strehimin Social”, i ndryshuar, përzgjedhja e subjekteve dhe familjeve përfituese bëhet nëpërmjet një Sistemi Pikëzimi i cili miratohet për çdo program nga njësia e vetëqeverisjes vendore bazuar në kriteret e përcaktuar me ligj. Bazuar në nenin 15 të ligjit Nr. 22/2018 i ndryshuar për “ Strehimin Social” u diskutua mbi sistemin e pikëzimit i cili do aplikohet në zbatim të programit të strehimit “Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme” si dhe për “Sistemin e pikëzimit për trajtimin sipas programit të subvencionit të qirasë në tregun e lirë” për vitin 2025.

Bazuar në ligjin Nr.22/2018 i ndryshuar “Për Strehimin Social” neni 16^s “Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve, “Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme” dhe “Sistemi i pikëzimit për trajtimin sipas programit të subvencionit të qirasë në tregun e lirë”. Bazuar gjithashtu në problemet sociale dhe nevojave të shfaqura në territorin e Bashkisë Vau Dejës, u dakortësua mbi vendojsen e përparësive në pikëzim të kategorive të vendosura në prioritet sipas ligjit .

Bashkëlidhur gjeni sistemin e pikëzimit.

Komisioni i Strehimit :

- Dajana Lleshi-Kryetar
- Silvana Ismailaj-Zv/Kryetar
- Marian Marku-Anëtar
- Indrit Kurtbegu-Anëtar
- Aurela Deda-Anëtar
- Suela Domnori-Anëtar
- Kujtime Nurja-Anëtar

Të pranishëm:

- Dajana Lleshi
- Silvana Isailaj
- Marian Marku
- Aurela Deda
- Suela Domnori
- Kujtime Nurja

1 Numri total i pikëve është 100 pikë.

1.1. Tabela nr. 1 - Formula e Pikëzimit për aplikantët në programin e strehimit social "Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme."

SISTEMI I PIKËZIMIT PËR TRAJTIMIN SIPAS PROGRAMIT TË "PROGRAMIT TË PËRMIRËSIMIT TË KUSHTEVE TË BANESAVE EKZISTUESE DHE ZONAVE TË PAPËRSHTATSHME"			
Nr.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT	Pikët e mbledhura
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	25	Shëno vetëm 1 nga kriteret.
A	Nuk disponojnë banesë në pronësi;	0	
B	Banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembje;	9	
C	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;	9	
Ç	Kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore;	7	
D	Familjet ose individët që humbasin banesën e tyre si pasojë e zhvendosjes ose zbatimit të një vendimi gjyqësor;	0	
DH	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike	0	
1.2	KUSHTET FAMILJARE	25	Shëno vetëm 1 nga

			<i>kriteret.</i>
A	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë, kur përfshihen dhe vajzat nëna;	8	
B	Të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;	3	
C	Familjet me më shumë se katër fëmijë;	6	
Ç	Familjet e reja;	5	
D	Të rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç;	3	
1.3	KÛSHTET SOCIALE	25	<i>Shëno deri në 3 kritere.</i>
A	Personat me aftësi të kufizuar, sipas pikës 28 të nenit 2 këtij ligji ;	4	
B	Individët me statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore dhe deri në moshën 30 vjeç;	3	
C	Familje e mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave të ish-pronarëve;	1	
Ç	Emigrantët e rikthyer, punëtorët emigrantë, azilkërkuesit, refugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese;	1	
D	Familjet e policëve të rënë në detyrë;	1	
E	Punonjësit e repartit RENE A	1	
F	Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi;	1	
G	Viktimat e trafikimit \viktimat e mundshme të trafikimit;	4	
Gj	Anëtarët e komunitetit Rom;	1	
H	Anëtarët e komunitetit Egjiptian;	1	
I	Të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pas ekzekutimit të dënimit;	1	

J	Vajzat nëna;	5	
K	Individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktimë për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor bazuar në vendimin e organit kompetent;	1	
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	25	<i>Shëno vetëm 1 nga kriteret.</i>
A	Të ardhura nën 70% të të ardhurave mesatare;	15	
B	Të ardhura 70%-100% të të ardhurave mesatare;	8	
C	Të ardhura 100%-120% të të ardhurave mesatare;	2	

Mënyra e llogaritjes:

- I. Pikët maksimale të çdo sistem pikëzimi është 100.
- II. Nuk mund të mbledhen brenda për brenda një kriteri pikët

1. Kriterit 1.1-Kushtet e strehimit
2. Kriterit 1.2-Kushtet familjare
3. Kriterit 1.4-Kushtet ekonomike.

4. Pikët nga A deri në fund të kriterit 1.3 Kushtet sociale, mund të mbledhen bashkë deri në tre gërma.


1 Numri total i pikëve është 100 pikë.

1.1. Tabela nr. 1 - Formula e Pikëzimit për aplikantët në programin e strehimit social "Programi i subvencionit të qirasë në tregun e lirë."


SISTEMI I PIKËZIMIT PËR TRAJTIMIN SIPAS PROGRAMIT TË "SUBVENCIONIT TË QIRASË, NË TREGUN E LIRË"			
Nr.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT	Pikët e mbledhura
1.1	KUSHTET E STREHIMIT	25	Shëno vetëm 1 nga kriteret.
A	Nuk disponojnë banesë në pronësi;	8	
B	Banojnë në banesa që paraqesin rrezik shembje;	0	
C	Banojnë në banesa të mbipopulluara, sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi;	7	
Ç	Kanë mbetur ose rrezikojnë të mbeten të pastreha, si rezultat i fatkeqësive natyrore;	4	
D	Familje ose individë që humbasin banesën e tyre si pasojë e zhvendosjes ose zbatimi të një vendimi gjyqësor;	4	
DH	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit, si rezultat i investimeve publike;	2	
1.2	KUSHTET FAMILJARE	25	Shëno vetëm 1 nga kriteret.

 1

A	Familje një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë, kur përfshihen dhe vajzat nëna;	8	
B	Të moshuarit që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t'u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore;	3	
C	Familjet me më shumë se katër fëmijë;	4	
Ç	Familjet e reja;	6	
D	Të rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç;	4	
1.3	KUSHTET SOCIALE	25	<i>Shëno deri në 3 kritere.</i>
A	Personat me aftësi të kufizuar, sipas pikës 28 të nenit 2 këtij ligji;	3	
B	Individë me statusin e jetimit që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesit shoqëror e deri në moshën 30 vjeç;	2	
C	Familje e mbetur e pastrehë përshkak të lirimit të banesave të ish-pronarëve;	1	
Ç	Emigrant të rikthyer, punëtorë emigrantë, azilkërkues, refugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese;	1	
D	Familjet e policëve të rënë në detyrë;	2	
DH	Punonjësit e repartit të ndërrjes së shpejtë FNSH	1	
E	Punonjësit e repartit RENE	1	
F	Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;	2	
G	Viktimat e trafikimit \viktimat e mundshme të trafikimit;	4	







GJ	Anëtarë të komunitetit Rom;	1	
H	Anëtarë të komunitetit Egjiptian;	1	
I	Të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pas ekzekutimit të dënimit;	1	
J	Vajza nëna;	4	
K	Individët që i përkasin komunitetit LGBTI, të cilët janë viktime për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor bazuar në vendimin e organit kompetent;	1	
1.4	KUSHTET EKONOMIKE	25	<i>Shëno vetëm 1 nga kriteret.</i>
A	Të ardhura nën 70% të të ardhurave mesatare	15	
B	Të ardhura 70%-100% të të ardhurave mesatare	8	
C	Të ardhura 100%-120% të të ardhurave mesatare	2	
	Totali i pikëve	100	

Mënyra e llogaritjes:

- I. Pikët maksimale të çdo sistem pikëzimi është 100.
- II. Nuk mund të mbledhen brenda për brenda një kriteri pikët

1. Kriterit 1.1-Kushtet e strehimit
2. Kriterit 1.2-Kushtet familjare
3. Kriterit 1.4-Kushtet ekonomike.

4. Pikët nga A deri në fund të kriterit 1.3 Kushtet sociale, mund të mbledhen bashkë deri në tre gërma.

